

VENDIM
Nr. 643, datë 22.7.2015

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2016-2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2016-2018, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama